



NEON A.S
RR.XHANFISE KEKO, Nd.168 , H.1, CP. 1005
TIRANA, ALBANIA
TEL: +355 42 377 773 FAX: +355 42 347 770
E-MAIL: info@neon.al WEB: www.neon.al

NEON AN – 601 NEODUR (ASTAR ME BAZE WHITE SPIRIT)

Skedë Teknike

PËRSHKRIMI: ASTARI NEON AN – 601, është një emulsion me bazë rrëshirash akrilike, tretës organik, dhe ka aftësi të lartë depërtuese në çdo lloj sipërfaqeje poroze. Përdoret për ambjentë të jashtme. Nuk krijon film sipërfaqësor, nuk pengon transpirimin (frymëmarrjen), nuk zverdhet dhe reziston ndaj kushteve klimaterike të disfavorshme. Ndalon karbonizimin, prishjen, rrit papërshkrueshmërinë nga uji dhe është ura ngjitesë më e mirë për hidroizolimim me hidroizolues akrilikë elastomërikë dhe gjithashtu për bojatisje me bojëra plastike dhe akrilike. Thahet shpejt, dallohet nga vaji i lirit dhe nuk shkakton zverdhje në bojrat plastike.

FUSHA E PËRDORIMIT: ASTARI NEON AN – 601 përdoret në sipërfaqe me beton, suva, panele çimentoje, pllaka gipsi, materiale asbest – çimento (eterniti), gëlqere, ngjites tavani, në mjedise me avuj uji si banja dhe kuzhina. Rekomandohet për sipërfaqe të jashtme me beton, suva, të cilat do të bojatisen për herë të parë ose për lyerje paraprake me astar tretësi për evitimin e situatave të tilla si plasaritje të suvasë etj.

NGJYRA: Transparente

PËRDORIMI: ASTARI NEON AN – 601, aplikohet me furçë ose me rrul. Kalohet vetëm një dorë. Hollohet me White Spirit 50 - 100 %. Deri në 50 % kur përdoret për tarraca, dhe deri në 100 % kur përdoret për mure. Mbulimi ose konsumi është 10 m²/lit kjo në varësi të thithshmërisë së sipërfaqes. Mjetet e punës me White Spirit.

TE DHENAT TEKNIKE:

- Ngjyra.....transparente
- Viskoziteti (Flow Cup Nr 4).....15 – 60 sec
- Densiteti.....0.81 (± 0.02)
- Fuqia mbuluese për lyerje të plotë.....12 m²/L
- Mbetja e thatë.....21 ± 2
- Koha e tharjes.....2 orë
- Temperatura e zbatimit + 5 °C deri në + 35 °C

- Rezistenca ndaj alkaleve e shkëlqyer

REZIKSHMËRIA: ASTARI NEON AN – 601, Kujdes! Është i ndezshëm duhet të përdoret në enë të përshtatshme për të shmangur ndotjen e mjedisit. Duhet të ruhet larg fëmijëve (S 2), irriton sytë dhe lëkurën (R36 / 38). Në rast kontakti me lëkurën, pastrojeni menjëherë me ujë të bollshëm (S 28). Në rast kontakti me sytë, shpërlajeni menjëherë me ujë të bollshëm dhe kërkoni ndihmën e mjekut (S 26). Përdorni doreza dhe maskë gjatë aplikimit (S 37 / 39).

AMBALAZHIMI: Ambalazhimi bëhet në kuti metalike 4L dhe 16L.

KUSHTET E RUAJTJES: Ruhet në ambiente me temperaturë mbi 0°C, dhe në ambalazh të mbyllur hermetikisht, për më shumë se një vit.